

**STATUTI DHE AKTI I THEMELIMIT**  
**I SHOQËRISË TREGTARE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**  
**OBG Tax & Law Studio SHPK**

**I. DISPOZITA TË PËRGJITHSIIME**

Sot më datë 28.12.2020, në Tiranë, në bazë të ligjit nr. 9901 datë 14.04.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", me vullnetin e tyre të plotë dhe të lirë, personat e mëposhtëm:

1. **Bledar Hitaj**, lindur në Vlorë, i datëlindjes 17.05.1980 dhe me banim në Tiranë, shtetas shqiptar, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, i identifikuar me letër njoftim me nr. **I00517093L**;
2. **Giomela Hitaj**, lindur në Divjakë, i datëlindjes 23.06.1979 dhe me banim në Tiranë, shtetase shqiptar, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, e identifikuar me letër njoftim me nr. **H95623150B**;

në cilësinë e "Ortakëve Themelues", me vullnet të lirë e të plotë e të singertë dhe iniciativën e lirë private, mbështetur në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, Kodin Civil në fuqi, Ligjin nr. 9901 datë 04.04.2008 "Për tregtarët e shoqëritë tregtare", dhe ligjin Nr. 9723, datë 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Biznesit", vendosën të themelojnë shoqërinë tregtare, me përgjegjësi të kufizuar **OBG Tax & Law Studio SHPK**.

Shoqëria Tregtare **OBG Tax & Law Studio SHPK** rregullon pozitën e saj juridike, marrëdhëniet ndërmjet ortakëve, funksionimin dhe kompetencat e organeve të saj, llojin e shoqërisë, kohëzgjatjen e veprimtarisë së saj, marrëdhëniet me të punësuarit, duke u bazuar në ligjin nr. 9901 datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", dhe dispozitat e tjera të legjislacionit shqiptar në fuqi që rregullojnë marrëdhëniet e shoqërive tregtare.

Ky statut është dokumenti i vetëm ligjor i shoqërisë, ku përcaktohet në mënyrë specifike themelimi dhe organizimi i shoqërisë.

**NENI 1**

**Emërtimi**

1. Emërtimi i shoqërisë është **OBG Tax & Law Studio SHPK**.
2. Shoqëria do të paraqitet në qarkullimin tregtar me emërtimin e saj **OBG Tax & Law Studio SHPK**.
3. Ndryshimi i emrit të shoqërisë mund të bëhet vetëm me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të shoqërisë.



## NENI 2

### Forma juridike

1. Shoqëria **OBG Tax & Law Studio SHPK**, është person juridik i të drejtës shqiptare, Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar (më poshtë e quajtur shoqëria).
2. Shoqëria fiton personalitetin juridik pasi të jetë regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit, në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj. Shoqëria do të ketë vulën e saj.
3. Shoqëria, pasi të ketë fituar personalitetin juridik, është përgjegjëse ndaj të tretëve për detyrimet dhe dëmet e shkaktuara gjatë veprimtarisë së saj përsa parashikohet në ligj.
4. Shoqëria **OBG Tax & Law Studio SHPK**, është një kompani, kapitali i së cilës ndahet në kuota dhe që themelohet nga ortakët që përballojnë humbje vetëm deri në kufirin e vlerës së kontributit të tyre në kapitalin fillestar.
5. Shoqëria udhëhiqet nga parimet e ekonomisë së tregut dhe ka për qëllim fitimin. Ajo respekton parimin e reciprocitetit.

## NENI 3

### Selia Qëndrore

1. Shoqëria do të ketë selinë qendrore në adresën: Rruga Frosina Plaku, Nr.40, AL-1023, Njësia 1004, Tiranë, Shqipëri.
2. Shoqëria mund të çelë agjensi, degë dhe përfaqësi në qytete të tjera të Shqipërisë, në përputhje me legjislacionin shqiptar.

## NENI 4

### Objekti i veprimtarisë

Objekti i aktivitetit të shoqërisë do të jetë:

Konsulencë ekonomike, tregtare, fiskale, juridike dhe kontabël. Asistencë në fushën fiskale, përpunim të dhenash në fushën ekonomike, studim tregu, analizë financiare, konsulencë në fushën e transaksioneve ndërkombëtare, etj.

Dhënie ndihmë juridike për negociime, hartimin, lidhjen dhe zbatimin e kontratave civile, tregtare, administrative, dhe për veprime të tjera juridike. Konsulenca juridike e financiare ne te drejten tregtare dhe te biznesit, ofrimi ndaj klientëve të saj të shërbimeve të plota në perzgjedhjen e formes tregtare me te pershtatshme per te ushtruar aktivitetin e tyre, ne procesin e regjistrimit, licencimit dhe ushtrimit te aktiviteti te tyre, apo ne raste si ndryshimi i formave organizative dhe strukture te shoqerive, shndërrimet e tyre, bashkimet apo ndarjet.



Dhënie ndihme juridike e ndërmjetësime për zgjidhje juridike me mirëkuptim e jashtëgjyqësisht.

Gjithashtu shoqëria mund të kryejë:

Çdo veprimtari të lejuar nga ligji dhe /ose pjesëmarrjen në çdo veprim apo aktivitet të ligjshëm që mund të kryejë një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e krijuar në bazë të legjislacionit shqiptar. Shoqëria në ushtrimin e aktivitetit të saj, do të marrë të gjitha autorizimet e lejet e nevojshme pranë institucioneve publike shqiptare, dhe do të mbështetet në rregullat dhe normat në fuqi në lidhje me ushtrimin e veprimtarisë së saj të rregullt ekonomike.

## NENI 5 Kohëzgjatja e shoqërisë

1. Shoqëria do të ketë një kohëzgjatje të pacaktuar.
2. Veprimtaria e shoqërisë fillon me regjistrimin në regjistrin tregtar të Qëndres Kombëtare të Biznesit.

## II. KAPITALI

### NENI 6 Kapitali themeltar i shoqërisë

1. Kapitali i regjistruar i shoqërisë është i përbërë nga kontributi në para i ortakëve në vlerën 100.000 (një qind mijë) lekë. Kapitali është tërësisht i nënshkruar dhe shlyhet nga ortaku pas regjistrimit të shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

Kapitali është i përbërë në 2 kuota, për secilin ortak një kuotë. Pjesëmarrja e ortakëve në kapitalin e shoqërisë do të jetë si më poshtë:

Pjesa që kuota e secilit ortak zë në kapital jepet si më poshtë:

- **Bledar Hitaj**, zotërues i një kuote , me vlerë të përgjithshme 50.000(pesëdhjetë mijë) lekë, që përbën **50 %** të kapitalit themeltar të shoqërisë;
  - **Giomela Hitaj**, zotëruese e një kuote , me vlerë të përgjithshme 50.000 (pesëdhjetë mijë) lekë, që përbën **50 %** të kapitalit themeltar të shoqërisë.
2. Ortakët në bazë të kërkesës së organit administrues, mund të sjellin para në shoqëri, sipas marrëveshjes paraprake të lidhur midis tyre. Kjo derdhje parash mund të bëhet në formën e zmadhimit të kapitalit ashtu si dhe në formën e financimit të shoqërisë. Në rastin e financimit të shoqërisë nga ortakët në formë huaje, nuk është e nevojshme të respektohet përpjesshmeria

- mes shumë së derdhur në shoqëri dhe kuotave të kapitalit që ortakët zotërojnë.
3. Nëse mes palëve nuk ka marrëveshje specifike, financimet në formë huaje të bëra nga ortakët do të konsiderohen si hua pa interes.

## NENI 7

### Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit

Kapitali i regjistruar i shoqërisë mund të zmadhohet ose të zvogëlohet nga Asambleja e Përgjithshme. Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet nëpërmjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, nepermjet emerimit nga gjykata kompetente e një eksperti të autorizuar për këto kontribute sipas kërkesës së administratorit.

Zmadhimi i kapitalit mund të vendoset kur e kërkojnë interesat e shoqërisë duke u vendosur rritja e vlerës së kuotës së ortakëve.

Asambleja e Përgjithshme, vendos për zvogëlimin e kapitalit të shoqërisë. Zvogëlimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakëve, e cila merr vendim në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit.

Zvogëlimi i kapitalit nuk duhet të dëmtojë kreditorët e as të krijojë pasiguri tek ata që kanë dhënë kredi para publikimit të zvogëlimin të kapitalit. Në të kundërtën Gjykata e konsideron të pavlefshëm këtë vendim mbi kërkesën e kreditorëve.

Në të gjitha rastet zvogëlimi i prek ortakët në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqësojnë.

## NENI 8

### Transferimi i kapitalit

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme nga ortaku, për sa nuk parashikohet ndryshe në statut.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

Transferimi i kuotave të ortakëve të shoqërisë brënda ortakërisë apo në drejtim të personave të tretë jashtë ortakërisë është i kushtëzuar në çdo rast nga ushtrimi i të drejtës së parablerjes në favor të ortakëve ekzistues.



Ortaku para se t'i transferojë në çdo formë kuotat e veta një ortaku ekzistues brënda shoqërisë apo një personi të tretë jashtë saj, detyrohet të njoftojë me shkrim paraprakisht të gjithë ortakët e tjerë ekzistues nëse dëshirojnë të blejnë kuotat me të njëjtat kushte ekonomike si dhe në mënyrë përpjestimore sipas kuotave që zotërojnë në kapital të shoqërisë.

Në rast se të gjithë ortakët nuk përgjigjen me shkrim brënda 20 ditëve nga njoftimi apo deklarojnë se nuk dëshirojnë të blejnë kuotat, ortaku është i lirë të transferojë kuotat e tij tërësisht apo pjesërisht në drejtim të personave të tretë jashtë ortakërisë.

Në rast se një pjesë e ortakëve ekzistues përgjigjen me shkrim brënda 20 ditëve dhe deklarojnë se dëshirojnë të blejnë kuotat, ortaku është i detyruar t'i transferojë kuotat e tij në drejtim të tyre në mënyrë të barabartë (d.m.th. nëse dy ortakë shprehin dëshirën për blerjen e kuotave, ato do t'u shiten të dy ortakëve në mënyrë të barabartë, pra 50% secilit).

## NENI 9

### Fondi rezerve

Shoqëria krijon fondin rezerve dhe fonde të tjera financimi për të përballuar nevojat e saj për zhvillimin dhe nxitjen ekonomike të veprimtarisë.

## III. TË DREJTAT DHE DETYRAT E ORTAKUT, ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME E ORTAKËVE

### NENI 10

#### Të drejtat dhe detyrimet e ortakëve

1. Ortakët mbajnë përgjegjësi për humbjet e shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkruara. Pasuritë e krijuara nga shoqëria gjatë aktivitetit të saj janë në pronësi të shoqërisë. Ato (pasuritë) mund të tjetersohen, të jepen me qira, me miratimin e Asamblesë së Përgjithshme. Në këtë rast vendimmarrja duhet të jetë unanime me 100% të kapitalit.
2. Ortaku gezon pjesëmarrjen në rezultatet e çdo forme dhe sasi të veprimtarisë së shoqërisë të parashikuara në statutin e saj.
3. Ortaku ka të drejtë të marrë të dhënat që kanë të bëjnë me gjëndjen ekonomike tregtare dhe veprimtarinë e shoqërisë si dhe me të gjithë dokumentat e përpunuara nga shoqëria, bilancet si dhe llogaritë ekonomike, etj.
4. Ortaku ka të drejtë të paraqesë propozime dhe shqyrtimin e tyre nga Mbledhja e Asamblesë së Ortakëve.
5. Ortaku ka të drejtë të heqë dorë nga shoqëria dhe mund të shesin kuotën e tyre në kapitalin shoqërisë, në përputhje me kushtet që i lejon statuti dhe ligji.



6. Heqja dorë nga shoqëria nuk e liron ortakun nga detyrimet financiare të marra më parë ndaj shoqërisë. Heqja dorë nga shoqëria nuk e liron atë nga detyrimet që ka deri në momentin e heqjes dorë dhe nuk e cenon atë në marrjen e të ardhurave që shoqëria ka siguruar deri në këtë moment.
7. Ortaku ka të drejtë të marrë pjesë në organet e shoqërisë që janë ose mund të krijohen nëpërmjet përfaqësuesve të tij duke patur të drejtën e votës.
8. Ortaku ka të drejtë të kërkojë në çdo kohë t'i jepen të gjitha informatat që kanë të bëjnë me gjendjen tregtare të shoqërisë si dhe të gjithë dokumentat e përpunuara të shoqërisë, si bilancet, llogaritë ekonomike etj.
9. Personat përgjegjës për administrimin e shoqërisë informojnë ortakët për ecurinë e shoqërisë, realizimin e objektivave, llogaritë, raportet për gjendjen dhe ecurinë e veprimtarisë së shoqërisë tregtare me partnerët nenkontraktore, raportet e organeve drejtuese apo të eksperteve kontabel të autorizuar, si dhe çdo dokument tjetër të brendshëm të shoqërisë.
10. Ortaku duhet të depozitojë kontributin e tij në përputhje me statutin. Ortaku jep kontributin e tij në shoqëri në para apo në natyrë, sipas menyrave dhe afateve të percaktuara në statut dhe në marrëveshjen e posaçme të lidhur midis tyre, në të cilën është percaktuar në mënyrë të detajuar kontributi i secilit dhe menyra e afatit të derdhjes së këtij kontributi në këtë shoqëri. Ortaku përgjigjet ndaj shoqërisë personalisht dhe në mënyrë solidare për dëmet e shkaktuara nga mospërbushja e këtyre detyrimeve apo nga përbushja e tyre përtej afateve përkatëse.
11. Ortakët kanë të drejtë të marrin pjesë në administrimin e shoqërisë nëpërmjet organeve të krijuar nga vetë ata.
12. Të kryejnë detyrat për realizimin e objektivave dhe të funksioneve të shoqërisë.
13. Pjesëmarrja në shoqëri nuk e pengon ortakun të ketë pavarësi ligjore për veprimtari të tjera dhe për të drejta të tjera pronësie. Ai nuk përgjigjet për detyrimet e shoqërisë që rrjedhin nga objekti i veprimtarisë së saj të kontributeve të tyre të kapitalit themelor të shoqërisë.
14. Personat përgjegjës për administrimin e shoqërisë informojnë të gjithë ortakët për ecurinë e veprimtarisë së shoqërisë tregtare dhe me kërkesën e tyre, duhet t'u vënë në dispozicion llogaritë vjetore, përfshirë llogaritë e konsoliduara, raportet për gjendjen dhe ecurinë e veprimtarisë së shoqërisë tregtare, raportet e organeve drejtuese apo të eksperteve kontabel të autorizuar, si dhe çdo dokument tjetër të brendshëm të shoqërisë.
15. Gjatë ushtrimit të të drejtave, ortakët veprojnë, duke marrë parasysh interesat e shoqërisë dhe të ortakeve të tjera. Ata gëzojnë të njëjtat të drejta kanë të njëjtat detyrime e trajtohen në mënyrë të barabartë. Ortakët respektojnë detyrimet që burojnë nga akti i themelimit dhe statuti. Ata përpiqen për zhvillimin normal të shoqërisë sipas objektit të veprimtarisë së saj.

## NENI 11

### Organi Vendimmarrës

Asambleja e Përgjithshme e Ortakeve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë.



Asambleja e Përgjithshme Ortakeve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj.

Asambleja e Përgjithshme e Ortakeve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve dhe vendos me shumicën e thjeshtë të votave të ortakëve pjesëmarrës për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin dhe zëvendësimin e administratorëve;
- ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë, miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- e) përcaktimi i strukturës së personelit të shoqërisë, përcaktimin e rregulloreve për procedurën e punës të administratës;
- ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit, përcaktimin e madhësisë së kuotave për formimin e kapitalit bazë të shoqërisë.
- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë, marrjen e vendimit për krijimin e filialeve të degëve e të përfaqësive si dhe për cedimin e veprimtarisë së tyre;
- h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- i) marrjen e vendimeve për kërkimin dhe përdorimin e kredive afatgjata.
- j) çështje të tjera të parashikuara nga ligji.

Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë. Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojë si përfaqësues i ortakëve në asamblenë e përgjithshme.

## NENI 12

### **Mënyra e thirrjes së mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve**

Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik përmban vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës dhe u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë së bashku me dokumentacionin justifikues bashkëlidhur.



Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme mund të thirret nga Administratori dhe ortakët.

Ortakët janë të detyruar që të deklarojnë pranë shoqërisë dhe azhurnojnë gjithmonë në rast ndryshimesh, adresën e tyre të banimit dhe atë të kontaktit.

Sipas rëndësisë së vendimeve që shqyrton, mbledhja e Asamblesë së ortakëve mund të jetë e zakonshme ose e jashtëzakonshme.

#### **Asambleja e zakonshme vendos:**

- Për çështje të tilla si emërimin ose shkarkimin e personelit sipas strukturave të ngritura nga shoqëria, Administratori, Likuidatori ose Likuidatorët, miratimin e raporteve të administrimit dhe kontrollit, miratimin e programit vjetor të veprimtarisë së shoqërisë, etj.

#### **Asambleja e jashtëzakonshme vendos:**

Për çështje si: ndryshimin e statutit, zvogelimin e pjesëve të kapitalit themeltar, zmadhimin e kapitalit themeltar, mbylljen e shoqërisë.

### **NENI 13**

#### **Kuorumi**

Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 60 për qind të kuotave.

Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar sipas nenit 87 të ligjit " Per Tregtaret dhe Shoqëritë Tregtare ", ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm, nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote ortakët që zotërojnë jo më pak se 51 per qind të kapitalit.

Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorunit të përmendur me lart, asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

### **NENI 14**

#### **Marrja e vendimeve**

Asambleja e përgjithshme vendos me  $\frac{3}{4}$  e votave të ortakëve zoterues të kapitalit të shoqërisë, për çështje të rëndësishme që kanë të bëjnë me ndryshimin e statutit,





zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e thjeshtë të votave të ortakëve pjesëmarrës, për çështje të tjera të zakonshme si :

- a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
- b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
- c) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- ç) përcaktimin e shpërblimeve
- d) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecures se veprimtarisë;
- e) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- f) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;

Cdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë QKR për të pasyqruar ndryshimet në skeden e shoqërisë.

#### **NENI 15**

#### **Përgjashtimi nga e drejta e votës**

1. Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse asambleja e përgjithshme merr vendim për:

- a) vlerësimin e veprimtarisë së tij;
- b) shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij;
- c) ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria;
- ç) dhënien ose jo të përfitimeve të reja.

2. Kur ortaku përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar, i autorizuari vlerësohet të jetë në të njëjtin konflikt interesi, ashtu si dhe ortaku, të cilin përfaqëson.

### **IV. VITI FINANCIAR DHE KUSHTET EKONOMIKE TË SHOQËRISË**

#### **NENI 16**

#### **Viti Financiar**

Viti financiar i Shoqërisë fillon me 1 Janar dhe përfundon më 31 Dhjetor. Përgjashtimisht, viti i parë financiar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe mbyllet më 31 Dhjetor. Veprimtaria e shoqërisë e realizuar pasqyrohet në bilancet e shoqërisë. Bilanci vjetor i shoqërisë nxirret brenda 31 Marsit të vitit pasardhës.

#### **NENI 17**

#### **Llogaritë vjetore**

Llogaritë vjetore inventari, raportet operationale të veprimtarisë së vitit financiar dhe raportet e vecanta të hartuara nga administratori miratohen nga Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve. Miratimi i dokumentave mbi veprimtarinë vjetore bëhet brenda një afati prej 6 muajsh nga data e mbylljes së vitit financiar deri në 30 qershor të vitit pasardhës.



## NENI 18

### Ndarja e kapitalit

Kur shoqëria pushon veprimtarinë e saj, pasi shlycn të gjitha detyrimet që ka, pjesën e mbetur të kapitalit dhe të të ardhurave i marrin ortakët themelues.

Fitimi neto i realizuar nga shoqëria, mbasi zbriten të gjitha detyrimet si dhe fondet e lëna rezervë për veprimtarinë ekonomike, për investime, për reklamën tregtare, etj. Përfitohen prej ortakëve themelues të kësaj shoqërie proporcionalisht sipas pjesëve takuese të tyre.

Ortakët përballojnë humbjet e shoqërisë deri në kufirin e vlerës së tyre të derdhur në formimin e kapitalit themeltar.

Pjesët e kapitalit themeltar janë plotësisht të transferueshme në rrugë trashëgimie në rast ndarje pasurie ndërmjet bashkëshortëve dhe nëpërmjet paraardhësve dhe pasardhësve.

Transferimi i pjesëve të kapitalit themeltar duhet të vertetohet me akt noterial. Shoqëria në emër të vet është pronare, përdoruese dhe disponuese e pasurive të saj, por gjithmonë në përputhje me qëllimin e objektit e veprimtarisë që ajo kryen.

Shoqëria mund të ofrojë për garanci edhe pasuri të saj për të marrë kredi bankare.

## NENI 19

### E drejta e shoqërisë mbi pasurinë

Shoqëria është pronare e pasurive të saj dhe ka të drejtë të përdorimit dhe disponimit të kësaj pasurie, në përputhje me qëllimin dhe objektit e veprimtarisë që kryen. Shoqëria gëzon të drejtat për mbrojtjen e pasurisë së saj në përputhje me legjislacionin shqiptar.

## V. ORGANET DREJTUESE

### NENI 20

#### Administrimi

1. Veeprimtaria eoperative e shoqërisë drejtohet nga Administratori i saj. Administrator i shoqërisë është Giomela Hitaj lindur në Divjakë, e datëlindjes 23.06.1979 dhe me banim në Tiranë, shtetase shqiptar, madhore me zotësi të plotë juridike për të vepruar, e identifikuar me letër njoftim me nr. H95623150B për një afat 3 (tre) vjet nga momenti i regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit, me të drejtë rinovimi automatikisht përveçse palët me shkrim vendosin ndryshe.



Emërimi i administratorit i prodhon efektet pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

2. Personi i mëposhtëm caktohet Administrator i shoqërisë i cili do të ushtrojë dhe mbajë në mënyrë të veçantë kompetencat e administratorit:

Të dhënat e identifikimit:

dhe specimenët e nënshkrimit:

**Giomela Hitaj**

Adresa: Rr. Thoma Koxhaj, Yzberish, Kashar,  
nd.21, h.2, ap.11 Tiranë



## NENI 21

### Kompetencat e Administratorit

Administratori ka të drejtë e detyrohet të:

- a) kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme. Raporton për realizimin e planeve të shoqërisë. Administron pasurinë e shoqërisë, duke përfshirë këtu mjetet financiare, brënda caqeve të vendimeve të marra nga organi administrativ i shoqërisë;
- b) përfaqësojë shoqërinë tregtare përpara të tretëve si në gjykatë, organe tatimore, klientë, furnitorë etj. Gjithashtu drejton e kontrollon veprimtarinë e adresave sekondare nëse ka;
- c) kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë. Organizon zbatimin e saktë të vendimeve të Asamblesë së Ortakëve;
- ç) përgatiti dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
- d) krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- dh) kryejë regjistrimet dhe dërgojë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Biznesit;
- e) raportojë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
- ë) Administratori ka të gjitha kompetencat për të kryer të gjitha veprimet që kanë të bëjnë me administrimin e zakonshëm të shoqërisë në interes të shoqërisë dhe në emër të saj .



f) Administratori i shoqërisë është i ngarkuar që të çelë llogarinë bankare në emër të shoqërisë sapo shoqëria të regjistrohet në regjistrin tregtar të Qendrës Kombëtare të Biznesit pranë çdo banke të nivelit të dytë që operon në Shqipëri.

Administratori është i detyruar të thërrasi Asamblenë e Përgjithshme, në rastet kur:

-sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.

-shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të miratuara.

Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Paditë, që lidhen me shpërblimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

## NENI 22

### Përgjegjësitë e Administratorit

Administratori është përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga asambleja që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse.

Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", administratori detyrohet:

1. a) të kryejë detyrat e tij të përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjedis;

b) të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;

c) të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;

ç) të parandalojë dhe mënjanojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personale me ata të shoqërisë;

d) të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.



2. Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjen ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.

3. Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standardet profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkuara.

4. Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratori është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit „ Per Tregtarët dhe Shoqërite Tregtare , kryen veprimet e mëposhtme:

- a) u kthen ortakëve kontributet;
- b) u paguan ortakëve interesa apo dividendë;
- c) u shpërndan aktivet shoqërisë;
- ç) lejon që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet;
- d) jep kredi.

Paditësit kanë të drejtë të ndjekin në rrugë ligjore shlyerjen e plotë të dëmit që i është shkaktuar shoqërisë, përfshirë edhe dëmshpërblimin financiar, nëse është e nevojshme. Asnjë vendim i asamblesë nuk mund të ndalojë ngritjen e kërkesë padisë kundër administratorit për gabimet e kryera prej tij gjatë ushtrimit të detyrës.

## **VI. PRISHJA –RIORGANIZIMI I SHOQËRISË**

### **NENI 23**

#### **Prishja dhe likuidimi**

Shpërndarja ose prishja e shoqërisë mund të behet ne cdo kohe :

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
- b) me vendim të Asamblese se Ortakeve;
- c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
- ç) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”;
- d) me vendim të gjykatës.

Ne kete rast Ortaket merrin vendim me shkrim ne të cilin parashikojne menyren e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar 1 apo disa likuidatore dhe shenuar ne cdo dokument



të nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesën shtese " Shoqëri në likuidim e sipër "

Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë pagueuse, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi.

Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Ortaket.

Nëse Ortaket nuk marrin një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

#### **NENI 24**

##### **Riorganizmi i shoqërisë bashkimi-ndarja**

Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas Vendimit të Mbledhjes së Përgjithshme të Asamblesë së Ortakëve, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Pjesën IX të Ligjit 9901 datë 14.04.2012 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare."

#### **NENI 25**

##### **Baza Ligjore**

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Për sa nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe çfaredo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

#### **NENI 26**

##### **Marrëdhëniet e punës në shoqëri**

Marrëdhëniet e punës në shoqëri, në degët e përfaqësimit rregullohen në përputhje me vendimin për krijimin e shoqërisë, legjislacionit shqiptar, me këtë statut si dhe nëpërmjet kontratës individuale të punës. Për çështje që nuk rregullohen në kontratën e punës, zbatohen dispozitat e legjislacionit të punës. Punësimi i punonjësve në shoqëri behet mbi bazën e kontratës individuale të punës.

#### **Neni 27**

##### **Dispozita përfundimtare**

1. Ky statut përbën dokumentin e vetëm të shoqërisë që parashikon themelimin dhe organizimin e veprimtarisë së shoqërisë. Ky statut mund të ndryshohet, rishikohet dhe/ose shfuqizohet pjesërisht ose tërësisht dhe të zëvendësohet me një statut të



ri vetëm me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve sipas shumicës së cilësuar të përcaktuar më sipër.

2. Për sa nuk është parashikuar në këtë statut, ortakët do t'i referohen legjislacionit tregtar shqiptar në fuqi si dhe praktikave tregtare në vënd.
3. Për mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe për çdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis Shoqërisë dhe të tjerëve, do të jetë kompetente Gjykata Shqiptare.
4. Ky statut hartohet dhe firmoset në 3 (tre) kopje origjinale, të gjitha me të njëjtën vlerë ligjore. Një kopje qëndron në dokumentacionin bazë të shoqërisë.

### **ORTAKËT THEMELUES E SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**

**Bledar Hitaj**



**Giomela Hitaj**

